



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavake

A nr. 482/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi duke vendsur përkizati me ankesën e Lidhjës Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Prizren, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lidhjës Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga subjekti politik LDK dega në Prizren, në të cilën theksohet se me datën 03.11.2013, në ora 15:01, në ditën e zgjedhjeve kemi vërejtur se në qendrën e votimit në Prizren, në shkollën Fillorre “Ibrahim Fehmiu”, 2002A, aktualisht po qëndron duke bërë presion të vazhdueshmëri një kandidat për asamble dhe militant i PDK-së Halil Thaqi. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografit si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 të LZP-së, parashihet se “ Mund të apelohet vendimet e PZAP-it sikurse PZAP-i, mund ti rishikoj cilindri nga vendimet marra pas prezantimit të faktave të reja nga pala e interesuar.

Me ankesën e parashtruar nga subjekti politik LDK pretendohet se në qendrën e votimit në Prizren në shkollën fillorre “Ibrahim Fehmiu QV.2001A, aktualisht po qëndronte duke bërë presion kandidati për asamble komunale Halil Thaqi. Nga dëshmit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshmëri pretendimet ankimore të ankuesit të LDK ndaj subjektit politik PDK-së. Mirpo pretendimet ankimore të kësaj natyre janë të pabazuara, pasiqë dëshmitë e ofruara janë të përgjithshme dhe të paqarta për të cilat nuk mund të vërtetohen.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkeljë e tillë, prandaj në kuptim të nënët 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartëpermendur u vendos si në diapositiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 482/2013 më datën 07.11.2013

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda njëzetekatër (24) orë nga moment i marrjes së këtij vendimi nga PZAP-i.